STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 28 dhjetor 2012

LETER E PERBASHKET E GUVERNATOREVE KUOMO (CUOMO), KRISTI (CHRISTIE) DHE MALLOI (MALLOY) PER DHOMEN E PERFAQESUESVE MBI PAKETEN E NDIHMES PER SENDIN (SANDY)

Pas miratimit nga Senati të paketës së ndihmës për Sendin (Sandy), Guvernatorët Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo), Kris Kristi (Chris Christie) dhe Danell Malloi (Dannel Malloy) dërguan letrën e mëposhtme tek çdo anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve:

28 dhjetor 2012

I dashur Anëtar i Kongresit:

Ndërsa ktheheni në Uashington, D.C. (Washington, D.C.) për të vepruar mbi punët e mbetura të 2012-tës, kërkojmë ndihmën tuaj për të përfunduar paketën e ndihmës federale për shtetet që u shkatërruan nga Uragani Sendi (Sandy). Presidenti Obama ka paraqitur një paketë të përgjithshme që u miratua në Senat dhe, nëse miratohet nga Dhoma e Përfaqësuesve, do të sigurojë ndihmë kritike për qindra mijëra biznese të vogla dhe pronarë të shtëpive në rajonet tona që kanë qënë duke pritur që kur stuhia goditi pothuajse dy muaj më parë.

Kurdoherë kur një krizë ose katastrofë natyrore ka goditur ndonjë pjesë të kombit, përfaqësuesit e zgjedhur nga rajonet e prekura gjithnjë kanë qënë më të zëshmit dhe më të zellshmit, duke u bërë thirrje kolegëve të tyre që të bëjnë detyrën e tyre dhe të votojnë për të dhënë ndihmën federale mjaft të nevojshme. Delegacionet e Kongresit të tre shteteve tona gjithnjë kanë qënë atje për të siguruar votat kritike për këto paketa të ndihmave, sepse kjo është Amerika – kur njëri nga ne është në nevojë, ne jemi gati për të dhënë një dorë ndihme.

Çdo herë që ka patur një stuhi ose një katastrofë edhe pranë madhësisë dhe shtrirjes së Sendit (Sandy), pavarësisht nga rajoni i vendit, Dhoma e Përfaqësuesve ka miratuar miliarda dollarë në ndihmë shtesë -- 290 miliardë dollarë gjithsej që më 1989 si pjesë e 35 ligjeve të veçanta shtesë të buxhetit.

Kërkojmë të njëjtën ndihmë të shpejtë tani. Çdo vonesë në miratimin e kësaj ndihme do të ishte pa precedent në historinë e kohëve të fundit dhe do të sinjalizonte një ndryshim në politikën federale për ndihmën për katastrofat.

Kështu pyetja për secilin dhe çdo anëtar të kësaj Dhome të Përfaqësuesve është: Nëse kjo stuhi do të kishte goditur zonën tuaj dhe do t'a kishte shkatërruar atë ashtu siç Sandy ka shkatërruar tonën, a do të thoni se Dhoma e Përfaqësuesve ka bërë aq sa duhet? Nëse shtëpitë dhe bizneset e dhjetra mijëra banorëve tuaj u shkatërruan, a do të qëndronit të heshtur? A do të lejonit që të kalonin muaj pa u marë veprim nga Dhoma e Përfaqësuesve për të ndihmuar?

Senati e ka miratuar këtë paketë të ndihmës në mënyrë të bashkuar dhe nuk ka asnjë arsye se pse Dhoma e Përfaqësuesve nuk mund të bëjë të njëjtën gjë. Ndërsa Dhoma e Përfaqësuesve rimblidhet këtë fundjavë për të ndihmuar që kombi të shmangë "greminën fiskale," mbani mend se katastrofat prekin çdo rajon të këtij kombi dhe se ne si një komb qëndrojmë të bashkuar në kohëra krizash.

Ne kërkojmë mbështetjen tuaj për këtë ndihmë.

Sinqerisht,

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo)
Guvernatori Kris Kristi (Chris Christie)
Guvernatori Danell P. Malloi (Dannel P. Malloy)

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418